

20180210288

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR SIGURIM TË
DETYRUESHËM PENSIONAL ME FINANCIM KAPITAL**

Neni 1

Në Ligjin për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13, 44/14, 192/15 dhe 30/16), në nenin 51 paragrafi (1) pika d) në alinenë 5 në fund të fjalisë shtohet lidhëza "ose".

Pas alinesë 5 shtohet aline e re 6, si vijon:

"-APTIS (APTIS)- së paku nivel B2 (B2)".

Pika gj) shlyhet.

Neni 2

Dispozitat nga neni 51 paragrafi (1) pika d) të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/10, 171/10, 36/11, 98/12, 13/13, 164/13, 44/14, 192/15 dhe 30/16), dhe dispozitat nga neni 1 i këtij ligji me të cilin neni 51 paragrafi (1) pika d) plotësohet me aline të re 6, nuk do të zbatohen nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji deri më 1 shtator 2018.

Neni 3

Anëtari i Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për Supervizion të sigurimit pensional me financim kapital i cili është emëruar në periudhën nga dita e hyrjes në fuqi e këtij ligji deri më 1 shtator 2018, është i obliguar ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj më së voni në afat prej një viti nga dita e emërimit të tij.

Anëtarit të Këshillit të ekspertëve të Agjencisë për Supervizion të sigurimit pensional me financim kapital i cili nuk do ta plotësojë kushtin për njohjen e gjuhës së huaj në afatin e përcaktuar nga paragrafi 1 të këtij neni i pushon mandati.

Neni 4

Autorizohet Komisioni Juridik Ligjvënës i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë të përcaktojë tekst të spastruar të Ligjit për sigurim të detyrueshëm pensional me financim kapital.

Neni 5

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e botimit në "Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".